

## DAXOROL Flexkleber C2

■ **Vendet e përdorimit:** -Ngjites për ngjitje të pllakave mbi pllaka të qeramikës, mozaikëve nga qelqi dhe porcelani në mure dhe dysheme. Dyshemetë e çimentos, suvatë e gipsit, gips karton pllakat paraprakisht medoemos duhet të lyhen me Daxorol Tiefengrund.



■ **Baza e materialit:**

Çimento ngjyre hiri apo e bardhë, lëndë të lehta mbushëse, rërë të çela dhe shtesa për përmirësimin e vetive përpunuese.

■ **Vetitë:**

Shumë fleksibël, i patretshëm në ujë, i përshtatshëm për nxehtë dhe ftohtësi, qëndrueshmëri të mirë. Për vendosje të mbulesave të qeramikës në vende me temperature te larta dhe te ulta si dushe, banjo, tualete dhe hapësira ftohëse.

■ **Kushtet e përpunimit:**

Gjatë përpunimit temperatura e ambientit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5°C. Deri te tharja e plotë duhet të mbrohet nga ngrica dhe rrezatimi direkt i diellit.

■ **Përgatitja e bazamentit:**

Bazamentet të jenë të pastra, të afta për bartje dhe pa mbetje vajrash dhe yndyrash. Sipërfaqet nga rëra dhe sipërfaqet thithëse paraprakisht duhet të lyhen me Daxorol Unigrund.

■ **Përgatitja:**

Thes 25kg C2 Flexkleber përzihet me 8,0 litra ujë deri në formimin e një llaçi pa toptha. Pas 5 min. masa e fituar të përzihet edhe njëherë me mikser.

■ **Përdorimi:**

Ngjitesi C2 Flexkleber merret me një mistri adekuate dhëmbëzore nga rostfracja dhe mundësisht të tërhiqet në një drejtim. Të mos hidhet më shumë ngjitës seç mund të ngjitet pllaka brenda kohës së ngjitjes. Perzierja me materiale tjera nuk është e lejuar.

■ **Udhëzime për rreziqe:**

Përmban çimento/hidrat gëlqeror Xi irritues. Të mbrohen lëkura dhe sytë.

■ **Deponimi:**

Të deponohet në vend të thatë. Afati i përdorimit 12 muaj.

■ **Të dhëna teknike:**

Thes 25kg, ngjyrë hiri, madhësia e kokrrës 0-0,7mm.

Harxhimi: 1,2kg/m<sup>2</sup>.

Pastrimi i veglave të punës të bëhet me ujë.